



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4851 prot.

Ballsh më, 27.09, 2024

VENDIM

Nr. 18 Datë 25/09 / 2024

**“PËR DHËNIE TË TITULLIT QYTETAR NDERI PËR Z. PËLLUMB MEHMETAJ”**

Në bazë të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit 139/2015, neni 54, pika m “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr. 112/2013, neni 15 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, shkresës me nr. 3562 prot., datë 19.07.2024 “Kërkesë për dhënie titull qytetar nderi i Mallakastrës për Z. Pëllumb Mehmetaj” të Shoqatës Patriotike Kulturore Mallakastra, shkresës me nr. 3562/1 prot., datë 23.07.2024 “Kërkesë për informacion mbi pastërtinë e figurës”, drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentin e ish Sigurimit të Shtetit”, shkresës me nr. 1259/4 prot., datë 15.08.2024 “Informim mbi rezultatin e verifikimit të pastërtisë për kandidatin e propozuar për marrjen e titullit të nderit”, relacionit me nr. 4142 prot., datë 21.08.2024 të Komisionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit, ngritur me Urdhërin e Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër nr. 126, datë 16.04.2024, procesverbalit të mbledhjes së datës 28.08.2024, procesverbalit të mbledhjes së datës 25.09.2024

VENDOSI

- I- Dhënien e titullit “Qytetar Nderi, Z. Pëllumb Muharrem Mehmetaj me motivacionin “Për kontributin e dhënë në fushën e mësimdhënies, përhapjen e dijes, kulturës si dhe në edukimin e brezave”.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

